



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

15 Mars 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

FSSHM: 3500 të siguruar shëndetësor i kanë shfrytëzuar shërbimet elektronike të fondit



Shkup, 14 mars – Rrethë 3498 të siguruar shëndetësor, persona zyrtarë dhe punëtor shëndetësor, vetëm për një muaj nga futja në përdorim të shërbimeve elektronike i kanë shfrytëzuar të njëjtat.

Siç theksohet në Kumtesën e Fondit për Sigurim Shëndetësor, më së shpeshti është shfrytëzuar shërbimi elektronik për vërtetimin e ndihmesave ortopedike, të cilën 2838 të siguruar e kanë shfrytëzuar dhe kanë parashtruar dokumentacion deri te mjekët amë dhe mjekët specialist përmes rrugës elektronike.

Nëdrsa Fondi për Sigurim Shëndetësor për përparimin dhe lehtësimin e komunikimit mes fondit dhe të siguruarve, ndërmarrjeve dhe të punësuarve shëndetësor para pak kohësh mundësoi një sër shërbimesh elektronike të publikuara në portalin e fondit me të cilat në mënyrë të lehtë dhe efikase të siguruarit shëndetësor mund ti realizojnë të drejtat e tyre ligjore pa pasur nevojë që për këtë gjë të vijnë deri te sportelet e fondit.

Me futjen e shërbimeve elektronike nga ana e Fondit për sigurim shëndetësor, persona e siguruar, ndërmarrjet dhe punëtorët shëndetësor e shmangin shkuarjen në shërbimet rajonale dhe me këtë edhe humbjen e kohës.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



TETOVA

shpejt dhe ndryshe

FSSHM: Deri më tani rreth 3.500 të siguruar i kanë shfrytëzuar shërbimet elektronike



Në kuadër të komunikimit të lehtësuar dhe të avansuar mes Fondit për sigurim shëndetësor dhe personave të siguruar, firmave dhe të punësuarve mjekësor, në portalin e Fondit kemi mundësuar shërbime elektronike nëpërmjet të cilave të siguruarit në mënyrë të shpejtë, të lehtë dhe efikase do mund t'a shfrytëzojnë të drejtën ligjore pa ardhur nëpër sportelet e Njësisve rajonale të Fondit.

Sipas të dhënave fillestare nga anlizat e Fondit për sigurim shëndetësor, brenda periudhës njëmuajore respektivisht nga fillimi i zbatimit të shërbimeve elektronike, 3.498 të siguruar, persona të autorizuar dhe të punësuar mjekësor i kanë shfrytëzuar shërbimet elektronike nga shtëpitë e tyre ose vendet e punës dhe kanë parashtruar kërkesë për të realizuar ndonjë të drejtë të sigurimit shëndetësor.

Njëra ndër shërbimet më të shfrytëzuara elektronike për këtë muaj është verifikimi i paisjeve ortopedike respektivisht 2.838 të siguruar e kanë shfrytëzuar këtë shërbim dhe në mënyrë elektronike i kanë dorëzuar dokumentet përmjes mjekëve amë dhe mjekëve specialist.

Këto shërbime cilësohen me rëndësi të madhe pasi mundësojnë një proces transparent dhe të drejtë ashtu që i siguruari/ personi i autorizuar i firmës në çdo kohë do mund t'a ndjekë statusin e kërkesës, të kenë informatë deri ku ka arritur procedura e përpunimit të lëndës dhe në rastet kur kërkesa të jetë e miratuar do mund t'a dijnë kur do të realizohet pagesa.

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë vazhdimisht do të angazhohet për avansimin e punës dhe komunikimin me personat e siguruar, firmat dhe të punësuarit mjekësor për të krijuar një sistem efikas dhe efektiv me qëllim që t'i kënaq pritshmëritë e personave të siguruar.